



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	266/20
Nr. i fq. / Br. st	- 26 -
Data: / Datum	30. 12. 2020
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVË

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

### PROCESVERBAL

#### NGA MBLEDHJA E -XIII-TË ME RADHË E -VIII- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 26 NËNTOR 2020

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri, duke filluar në orën 10:50.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Fitim Halili, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Ilir Krasniqi, Ismet Hajrizi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Melihate Basholli-Latifë, Suzana Syla, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

**Munguan:** Hysni Gërguri dhe Bahrije Ademi Murati.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z. Xhafer Tahiri, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtar tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 33 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe përmarrjen e vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

*Në fillim të mbledhjes z. Ilir Krasniqi dha betimin para kuvendit, duke u bërë anëtar i kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me të drejta të plota.*

Kuvendi me një minutë heshtej nderoj jetën dhe veprën e Dr. Safet Idrizit, ish-anëtar i kuvendit, dhe Emin Ibishit ish zyrtar për informim në Komunën e Vushtrrisë të cilët ndërruan jetë muajin e kaluar.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-** pasi i përskündetë të pranishmit tha se Komuna e Vushtrrisë ende pa stacion të autobusëve edhe përkundër faktit se Xhafer Tahiri, kryetar i komunës, në vitin 2017 pati premtuar se ky projekt do të përfundonte brenda mandatit të tij katër vjeçar, dihet tashmë që ende as lokacioni për ndërtim nuk është caktuar. Të gjithë e dimë se në tetor të vitit 2019 na e sollën në kuvend një propozim-vendim për Caktimin e Interesit të Përgjithshëm për Pronën e Paluajtshme në parcelën “Tek ish Motel Vicianumi” e cila evidentohej në emër të Shërbimit Korrektues të Kosovë, pra në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Kuvendi me shumicë absolute të votave e pat votuar sepse i besonte arsyetimit të Drejtorisë së Kadastrit, (Dora në zemër unë e

pata quajtur arsyetim të varfër nga drejtori). Jo larg nga sot, në debatin “Jeta në Komunë” e udhëhequr nga Jeta Xharra , kryetari ynë e paraqiti një projekt për ndërtimin e stacionit të autobusëve dhe ishte aq bindës në paraqitjen e atij projekti sa edhe mua më hutoi, (thash me vete e paska kryer çështjen e pronës me nivelin qendror). Të nderuar anëtarë të Kuvendit! Për pronën e cekur më lartë Ministria e Drejtësisë i paska kryer të gjitha procedurat e dhënies në shfrytëzim për 15 vite një operatori privat, për çudi pa asnje konsultim të vetëm me Komunën e Vushtrrisë. Shkoi edhe ky premtim! Pyetja e tij për ekzekutivin është: A do të vazhdoni betejën për gjetjen e një lokacioni tjeter për ndërtimin e stacionit të autobusëve, apo keni menduar në formë tjeter ta ndërtoni në të njëjtën pronë, sepse unë mendoj se vendimi numër 293/19 i datës 31.10.2019 duhet të shfuqizohet. Në fund të diskutimit ai kërkoi të informohet nga Drejtoria e Arsimit, se cila është arsyja që fëmijë tanë nuk kanë nxehje nëpër disa shkolla, sot është 26 nëntori dhe temperaturat kanë rënë nën zero.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-në adresimin e tij para kuvendit fillimisht shprehu ngushëllime familjes, PDK-së dega në Vushtrri dhe komunitetit shëndetësor për vdekjen e Dr. Safet Idrizit i cili është doktori i parë në komunën tonë i cili humbi betejën me covid-19. Po ashtu ai shprehu ngushëllime për vdekjen e punëtorit komunal Emin Ibishi i cili ndërroj jetë muajin e kaluar. Tutje duke ju referuar pyetjes së anëtarit të kuvendit z.Klinaku, njoftoi se në buxhetin e aprovuar për vitin 2021 janë planifikuar 200,000.00€ për ndërtimin e stacionit të autobusëve. Edhe në këtë vit kemi pasur 200,000.00 € për këtë projekt përfat të mirë edhe në këtë vit por edhe përfitit e ardhshëm mjete financiare janë nga të hyrat vetanake dhe ato nuk mund të shkojnë në suficit por transferohen në buxhetin e vittit të ardhshëm, andaj komuna nuk ka humbur mjetet financiare lidhur me këtë projekt. Njoftoi se ka zhvilluar negociata me Qeverinë e Kosovës, dhe personalisht ka dërguar letër kryeministrin aktual por edhe dy kryeministrave të kaluar, që prona që u potencua të kthehet komunës për ndërtimin e stacionit të autobusëve, edhe vendimi i kuvendit është marrë pikërisht përfatë qëllim edhe mjetet financiare janë ndarë po me këtë qëllim. Tani Ministria e Drejtësisë në arsyetimin e saj kanë deklaruar se është hapësirë shumë e madhe për stacion të autobusëve dhe se ata kanë nevojë ta shfrytëzojë përfitë vjelë mjete financiare përfitë nevojat e Drejtorisë së Burgjeve. Ministri i Drejtësisë ka nënshkruar një kontratë përfit dhënie në shfrytëzim atë pronë në afat prej 15 vite, në këtë kontratë është paraparë që qiramarësi mund të bëj marrëveshje me institucionet publike të Republikës së Kosovës që parcelën apo një pjesë të parcelës të shfrytëzoj përfit nevoja të tyre, përkatesisht Komunën e Vushtrrisë përfit zhvillimin e projekteve përfit ndërtimin e stacionit të autobusëve me kusht që mos të shkelen kriteret e përcaktuar nga shërbimi korrektues përdorim të pronës. Me fjalë tjera me insistimin e komunës është krijuar mundësia që në atë pronë të ndërtohet stacioni i autobusëve. Përfat këtë kur të vjen kërkesa përfat këtë projekt, do procedohet në kuvend përfit dhënie lejen përfit ndërtimin e stacionit të autobusëve. Ministria gjegjëse i ka dhëni mundësi operatorit ekonomik që ti mundësohet komunë zhvillimi i projektit përfit ndërtimin e stacionit të autobusëve në hapësirën që është e përshtatshme, përfat këtë do të shikohen modalitet e ndërtimit të këtij objekti qoftë duke paguar një qira dhe duke lejuar operatorin që të ndërtoj objektin, apo që komuna ta ndërtoj objektin ashtu që mos të paguajmë qira por kjo do të vendoset bashkë me kuvendin e komunës. Komuna i ka të siguruara mjetet financiare përfit ndërtimin e këtij objekti, por po ashtu komuna mund të kushtëzoj operatorin ekonomik që ai ta ndërtoj këtë objekt dhe që komuna ta marr me qira këtë objekt. Në këtë kontekst ai vlerësoi se komuna duhet ta analizoj që a ka më tepër benefit ti shpenzoj 300,000.00 € përnjëherë përfit ndërtimin e stacionit të autobusëve, apo që përfit 30 vite e ardhshme të paguaj qira vjetore përfit atë objekt, mjetet janë vetanake sepse kompania është publike lokale dhe komuna është aksionari kryesor, kuvendit do të vendos aksionarët dhe bordin e drejtorëve dhe drejtorin e Stacionit të**

Autobusëve. Andaj vlerësoi se komuna i ka këto opsione për të cilat duhet të vendos qoftë duke paguar qiranë apo duke ndërtuar vetë objektin e stacionit të autobusëve dhe u zotua se edhe një vit sa i ka mbetur mandat nuk do ta përfundoj pa bërë komunën me stacion të autobusëve si mandat i parë i tij si kryetar komune.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-në emër të grupit kuvendar të PDK-së, propozoi që pika e 4 në renditje e rendit të ditës të zhvendoset pas pikës 15, pasi këto pika ngërthejnë në vete elementet të përbashkëta të cilat duhet të aprovojen bashkërisht pasi kanë lidhshmëri njëra me tjetrën.**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-propozoi që pika e gjashtë (6) në renditje propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit Nr.357/20 i datës 26.12.2019 të hiqet nga rendit i ditës, që lidhet me formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Lidhur me këtë ai sqaroi duke arsyetuar me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme del obligimi që para çdo vendimi paraprak për dhënën në shfrytëzim të pronës duhet të themelohet komision i ri dhe se në rastin konkret bëhet fjalë për një vendim tjetër që është marrë në kohen kur ka qenë në fuqi një ligj tjetër për dhënien e pronës në shfrytëzim.**

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-sqaroi se procedimi i këtij propozim-vendimi është bërë konform dispozitave të ligjit të ri për dhënën e pronës komunale në shfrytëzim sipas principit që para çdo dhënie në shfrytëzim duhet të themelohet komision i ri.**

**Në fund të debatit për rendin e ditës, Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me vota “unanime” aprovoi këtë:**

#### R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 29 tetor 2020;
2. Shqyrtimi i Draft – statutit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të teatrit të qytetit të Vushtrrisë (**shqyrtimi i dytë**);
3. Shqyrtimi i Draft – rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës (**shqyrtimi i parë**);
4. Shqyrtimi i propozim – vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh;
5. Shqyrtimi i Propozim vendimit për formim të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
6. Shqyrtimi i konkursit publik për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale;
8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit 01 nr. 89/20, dt. 28.05.2020;
9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit 01 nr. 57/18, dt. 22.02.2018;
10. Shqyrtimi i Propozim – vendimeve për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë;
11. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq – dega në Vushtrri;

12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A Vushtri;
13. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal;
14. Shqyrtimi i Draft - Strategjisë Zhvillimore të Komunës për vitet 2020 – 2025 (**shqyrtimi parë**);
15. Shqyrtimi i Draft – Strategjisë të përkrahjes së prodhuesve në Komunën e Vushtrrisë (**shqyrtimi parë**);
16. **Të ndryshme.**
17. Shqyrtimi i Draft-rregullores për shfuqizimin e rregullores të tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2021;
18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e normave të tatimit në pronën e paluajtshme.

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 29 tetor 2020;**

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 29 tetor 2020.*

**2. Shqyrtimi i Draft – statutit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të teatrit të qytetit të Vushtrrisë (**shqyrtimi i dytë**);**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-ngriti shqetësimin e tij për mënyrën e mbajtjes së mbledhjes, në sallën e kuvendit, ku është një hapësirë e ngushtë dhe ka rrezik për bartjen e virusit të quajtur covid-19.**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se vërtet është shqetësuese që në këto kushtet të mbahet mbledhja ku ka rrezik të shkaktimit të infektimit me covid-19 dhe propozoi që të gjendet një lokal tjetër i përshtatshëm apo të shtyhet mbledhja për një datë tjetër.**

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-propozoi që mbledhja e kuvendit të mbahet në platformën online në google meet.**

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-tha se është shqetësuese fakti që mbledhja e kuvend po mbahet një numër kaq të madh njerëzish dhe në një hapësirë të ngushtë ku ekziston rrezik për bartej të corona-virusit. Ai vlerësoi është shumë keq që drejtori i Drejtorisë së Inspektive të marr pjesë në këtë takim i cili është i thirrur ti zbatoj masat anti-covid.**

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit- paraqiti një rezyme të shkurtër për jetën dhe veprën e aktorit: Adem Mikullovci , i lindur me 21 Dhjetor 1937 , në Vushtrri, i cili me punën dhe veprën e tij njihet në të gjithë shqiptarinë. Adem Mikullovci bëri 45 role kryesore, luajti në 70 role të dyta, në film dhe teatër. Aktori i madh shqiptarë morri zemrat e të gjithëve me talentin e tij, na bëri të qajmë në shumë filma , kushtuar sakrificës dhe rezistencës së shqiptarëve ndaj agresorit serb. Kur ishim të lodhur dhe të stresuar, ai na bëri të qeshim me humoret e tij. Aktorin e deshën të gjithë, fëmijë e pleq. Kur vatani kishe nevojë, Adem Mikullovci u përgjigj. Ai ishe deputet , i 2 Korrikut të vitit 1990, duke shpallur edhe deklaratën e Kushtetutës së Republikës të Kosovës. Këto ishin në pikat te shkurtra , se baci Adem kishe 50 vite karriere. Andaj mendoj që është personalitet i duhur , që Teatri i qytetit te Vushtrrisë ta mbaj emrin e tij. Sigurisht që do të jetë frymëzim për aktorët që do të luajnë shfaqje , në teatrin qe mban emrin e tij. Të nderuar kolegë , deputet ju lus që të mendoni me gjakftohtësi, dhe me arsyë, është nder edhe për ne si deputetë, që na u dha mundësia të votojmë që teatri ta mbajë emrin ADEM MIKULLOVCI, ka pak rëndësi kush propozoi, është**

shumë me rendësi, që të nderojmë figurat e ndritura të shtetit tonë. Fatkeqësisht kemi dëgjuar fjalë që Adem Mikullovc i nuk bëri asgjë për Vushtrrinë. Realiteti është që Adem Mikullovc i bëri për të gjithë shqiptarinë, e për Vushtrrinë nuk paska bërë asgjë. Këta që thanë kështu duhet të kërkojnë falje.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha** se duke marrë për bazë edhe deklarimet e mëhershme, por edhe duke mos e kontestuar kontributin e aktorit Adem Mikullovc, por edhe propozimin e komunitetit artistik që teatri i qytetit të mbaj emrin e Xhemajl Cecelis. Grupi kuvendar i PDK-së ka vendosur që të mbështet propozimin që teatri të mbetet me emrin zyrtar siç edhe është Teatrit i Qytetit të Vushtrrisë TQV. Në këtë kontekst kërkoi që fillimisht të votohet për propozimin <Teatrit i Qytetit të Vushtrrisë> dhe kësisoj nuk do të ketë nevojë fare për votim sepse statutit i këtij teatri nuk do të ndryshohej fare. Në të kundërtën nuk është mirë që të sfidohemi me propozime pasi që nëse kemi dy apo më shumë propozime atëherë duhet të aplikohet proceduar e votimit të fshehtë. Në fund ai vlerësoi se kërkoi nga të gjithë që mos të krijojnë insinuata përfituar poena politikë duke përdor emra të figurave të ndryshme publike.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha** se vërtet ky propozim për emërimin e teatrit ka ardhur në kuvend për diskutim disa herë dhe kishte me qenë mirë që kuvendit ta vendos këtë çështje me vota të fshehta. Ai vlerësoi se emri i aktorit Adem Mikullovc është i pakontestueshëm dhe nuk kishte me qenë mirë që të ndahemi sa i përket emërtimit të teatrit.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-vlerësoi** se fillimisht duhet të qitet në votim plotësim-ndryshimi i statutit të teatrit të qyteti, nëse ky propozim kalon atëherë mund të përgatiten fletëvotimet për votim të fshehet sipas rregullores së kuvendit për radhitjen alfabetike të propozimeve sipas mbiemrit.

Në vazhdimi kuvendi me vota unanime vendosi që të formoj komisionin për mbikëqyrjen e procesit të votimit të fshehtë për emërimin e Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë, në përbërjen si në vijim:

**Ilir Krasniqi, anëtar i komisionit PDK;**  
**Agim Bregaj, anëtar i komisionit LDK;**  
**Ymer Haradinaj, kryesues i komisionit LVV.**

Pas përfundimit të votimit të fshehtë, lidhur me emërimin e Teatrit të Qytetit të Vushtrris Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë vendosi me sa vijon:

Propozimi i emërtimit të teatrit me emrin e "Adem Mikullovc" mori 19 vota;  
Propozimi që emërtimi i teatrit të jetë: "Teatri i Qytetit të Vushtrrisë TQV" mori 13 vota dhe  
Propozimi i emërtimit të teatrit me emrin e "Xhemajl Cecelisë" pati zero (0) vota.

*Nga të cekurat më lartë, kuvendit me 19 vota "për" aprovoi draft-statutin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë duke e emërtuar atë me emrin e aktorit "Adem Mikullovcit"*

3. Shqyrtimi i Draft – rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës (**shqyrtimi i parë**);

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

**1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft- Rregullorja për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më Pak se Një Vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.**

**2. Diskutimi publik fillon nga data 30 nëntor 2020 dhe zgjat deri më 30 dhjetor 2020.**

**3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparency në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparency 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.**

**4. Obligohet komisioni komunal që si hartues i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2020 për Transparency në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparency 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet zyra e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin dhjetor 2020.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.**

**4. Shqyrtimi i propozim – vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh;**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se janë për që ky propozim-vendim të aprovohet por se ka disa dilema për të cilat nevojiten sqarimet ligjore nga Zyra Ligjore e Komunës. Tujte shtoi se në pikën dy të këtij propozim-vendimi thuhet: Ngastrat kadastrale si në pikën 1 (një) të këtij vendimi, iu jepen në shfrytëzim afatgjatë subjekteve afariste për ushtrim të veprimtarive përpunuese dhe prodhuese. Dilema në këtë rast është se kriteret për dhënien e pronës në shfrytëzim a duhet të vendosen në propozim-vendim apo në konkurs. Lidhur me këtë pikë ai propozoi që afati i dhënies së pronës në shfrytëzim të jetë nëntëdhjetënëntë (99) vite, kjo përfaktin se kemi të bëjmë me investime kapitale të cilat do të janë të qëndrueshme, në të kundërtën komuna duhet ta rezervoj të drejtën për rikthimin e pronës. Pastaj të mundësohet përfitimi gjegjësisht i konkurrimit nga operatoret ekonomik të jetë prej  $1000\text{ m}^2$  deri në  $5000\text{ m}^2$ , tek pika 2.4 propozoi që të kërkohet me rastin e nënshkrimit të kontratës 5% e vlerës së investimit të parashikuar (përmes garancionit bankar). Trajtimi i kësaj zone ekonomike duhet të ketë përbazë rritjen e punësimit, investimit dhe konkurrencës në komunën tonë. Mandej vlerësoi dhe ftoj qeverinë komunale që të filloj me hartimin e dokumenteve komunale për zhvillimin e projektit të zonës ekonomike në Banjësk, ashtu që operatoret ekonomik të kenë mundësin e përfitimit të pronës 2-3 hektarë pronë. Ai më pastaj kahasoj zonën ekonomike të Drenosit duke tërhequr paralele ku në këtë fundit ka raste kur një operatori ekonomik iu janë dhënë  $6000\text{ m}^2$  dhe ai operator punëson 11 punëtor, atëherë shtrohet pyetja se çfarë leverdie ka komuna që pronë ta jepe në shfrytëzim kësosoj. Zona ekonomike e Drenosit kap një sipërfaqe prej 24 hektar pronë dhe punëson vetëm 341 punëtor e që del se është një investim jo i qëlluar, ndërsa tek zona jonë ekonomike kemi pak më shumë se 14 hektarë pronë,**

në këtë rast 30 deri 40 e sipërfaqes shfrytëzohet me rrugë dhe infrastrukturë atëherë mbeten në dispozicion për shfrytëzim rreth  $10000\text{ m}^2$  për zhvillim të afarizmit dhe në këtë rast nëse vendosen 70 biznese me nga 10 punëtor =700 punëtor, që i bie për gjysem më shumë të punësuar se sa zona ekonomike e Drenasit. Qëllimi i krejt kësaj është që të kemi kufizim sa i përket bizneseve të mëdha që të vazhdohet në kontinuitet që ato biznese të vendosen në zonën ekonomike në fshatin Banjësk. Ndërsa qëllimi i zonës në Lumadh duhet të jetë koncentrimi i bizneseve të vogla dhe të mesme dhe rritja e punësimit.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-vlerësori** se është i nevojshëm mendimi profesional i zyrës ligjore, pasi që është diskutabile, se a kemi të drejtë që propozim-vendimi paraprak ti fusim këto kriterë. Sa i përket çmimit dhe afatit të dhënies së pronës në shfrytëzim ato duhet të futen në propozim-vendim, por se kriteret tjera duhet të vendosen tek konkursi për dhënien e këtyre pronave në shfrytëzim. Pastaj duke ju referuar pikës 2 të propozim-vendimit propozoi që të ndryshohet teksti i këtij paragrafi si në vijim: ngastrat kadastrale të cekura si në pikën 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë subjekteve afariste për ushtrimin e veprimtarive prodhuase përpunuese në vend të kësaj të bëhet ndryshimi *< për veprimtari ekonomike sipas Ligjit për Zonat Ekonomike>*. Kjo duke marrë për bazë që për këto zona ekziston një ligji specifik dhe nëse lihet ashtu si është ka dorjen që mos po bëhen kufizime sa i përket investimeve të subjekteve afariste. Pastaj tek sipërfaqja në bashkëpunim me drejtoritet tjetra komunale janë rënë dakord që të kemi 3 zona të dhënies së pronës në shfrytëzim duke caktuar sipërfaqen nëpër zona. Kjo përfaktin se lejohet që operatoret ekonomik të aplikojnë pa e ditur kuotat e sipërfaqes, do të vështirësoset puna e komisionit pasi nuk e dimë se si do të veprohet. Dhe këto zona do të ishin me këto sipërfaqe: zona e parë I operatorët ekonomik do të mund të përfiton pronë deri në 50 ari, në zonë e II 50 ari deri në 1 hektarë dhe zona e tretë III mbi një (1) hektarë. Kjo është mirë të vendoset kështu përfaktin se e qartëson idenë e biznesit se çfarë po kërkon të investoj dhe do ta kërkoj sipërfaqen që dëshiron ta merr por në të njëjtën kohë do ta lehtësonte shumë punën e komisionit.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha** se përfundimi i projektit për zonën ekonomike në fshatin Lumadh është e mira më e madhe që i ka ndodhur Komunës së Vushtrrisë. Meqë jemi duke u ballafaquar për herë të parë me një investim të tillë është i mendimit që përvojat e njëjta *lege artis* të shfrytëzohen edhe në zonën ekonomike në fshatin Banjësk. Tutje njoftoi kuvendin se tashmë kanë filluar procedurat dhe ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që zonën ekonomike në Banjësk ta shpallin zonë të lirë ekonomike ndërkombëtare dhe kemi premtim që kjo shumë shpejt do të bëhet, po ashtu është lënë edhe kryçja në autostradë tek fshati Sllatinë, dhe në projektin e Ministrisë së Infrastrukturës do të jetë edhe kryçja në autostradë tek fshati Banjësk, kështu që përbizneset e Vushtrrisë do të kemi hapësira të mira. *Pastaj vlerësori dhe propozoi që tek pika 2.1 e propozim-vendimit në tri (3) vitet e para nga data e nënshkrimit të kontratës me komunën, bizneset nuk do të paguajnë kompensim, ndërsa pas tri (3) viteve do të paguajnë 0.05 € (pesë cent) për  $\text{m}^2$  në muaj.* Meqenëse është hera e parë që po mundësohet vendosja e bizneseve në zonë ekonomike, nuk është mirë të kufizohemi vetëm deri në  $1000\text{ m}^2$  sepse kështu nuk mundemi ti tërheqim biznese e mëdha dhe se qëllimi është ti tërheqim edhe bizneset e mëdha. Andaj ndarja nëpër zona është shumë më e mirë përfaktin se bizneset janë të përcaktuara ashtu që do ta dimë që i kemi deri në 10 vend me sipërfaqe deri në 50 ari, apo 5 vende me sipërfaqe deri në 1 hektarë dhe kemi me i pasur 3 vende me sipërfaqe mbi 1 hektarë, kjo formë do ta lehtësoj tej mase punën dhe në fund kuvendi do ti vendos për caktimi e bizneseve konform propozimit të komisionit. Synimi i komunës është që deri në fund të muajit janar të vitit të ardhshëm të përfundojnë të gjitha procedurat dhe të fillohen investimet nga ana e operatorëve ekonomik.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-përsëriti** se qëllimi i këtij projekti për zonën ekonomike është rritja e numrit të vendeve të punës. Dhe nëse dëshirojmë të shkojmë sipas opsonit të caktimit të limitit të maksimumit dhe të minimumit dhe me kalkular se vërtet do të hapën më shumë vende të reja pune nëse shkohet me sipërfaqe maksimum deri  $5000\text{ m}^2$  do të mund të kemi  $700-1000$  vende të reja pune, por nëse shkohet me opsonin me sipërfaqe të mëdha prej  $1-2$  hektarë atëherë do të dështojmë sikurse është rasti me Komunën e Drenasit sa i përket numrit të punësuarve ku do ti kemi  $200-300$  të punësuar dhe kështu nuk do të arritet qëllimi. Nëse planifikojmë të vendosen deri në  $70$  biznese, ku sipërfaqja e nevojshme do të variroj nga  $1000$  deri në  $2000\text{ m}^2$  atëherë mundësia e hapjes së vendeve të reja të punës do të jetë më e madhe dhe shkon nga  $700-1000$  vende të reja pune. Qëllimi i këtij projekti është rritja e punësimit, zhvillimi ekonomik dhe konkurenca mesë bizneseve. Pastaj propozoi që deri në  $30\%$  e zonës mund të shfrytëzohet me sipërfaqe më të madhe se  $50$  ari, kurse të tjerat munden me qenë në këtë përqindje.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha** se shumë më e leverdishme do të jetë që në zonën ekonomike të vendosen  $5$  biznese të mëdha që punësojnë nga  $200$  e që bëjnë  $1000$  punëtor, sesa ti vendosim  $50$  biznese që punësojnë nga  $5$  punëtor e që bëjnë gjithsej  $250$ . Ai njoftoj se interesimi i bizneseve deri tash për vendosje në këtë zonë ka qenë tepër i madh dhe atë nga kompanitë e mëdha. Andaj vlerësoi se është më mirë që mos të kemi kufizimi sa i përket sipërfaqes, nga fakti se mund të kemi kompani të mëdha të cilat janë të interesuara për të marrë pronë në sipërfaqe më të madhe. Ideja e zonës ekonomike është tu bëjmë zgjidhje kompanive të cilat nuk hapësirë fizike dhe janë nëpër lagje e të cilat shkaktojnë edhe problem për qytetarët. Ai shtoi se prioritet do tu jepe kompanive prodhuase e përpunuase që rritë zhvillimin ekonomik dhe ndikon direkt në punësim kjo është e shprehur edhe në kriteret në konkursin publik të cilin pas pak do ta shqyrtojmë bashkërisht. Ku flitet për kriteret që dalin nga ligji dhe udhëzimi administrativ për zonat ekonomike atëherë, komisioni ka përbërë këto kritere gjatë vlerësimit të ofertave: punësimi  $40$  pikë, vlera investive  $30$  pikë, veprimtaria prodhuase  $30$  pikë, përpunuase  $20$  pikë, shërbysese  $10$  pikë. Konform këtyre kritereve nëse punësimi është top prioritet atëherë më mirë është që të kemi  $5$  biznese me nga  $10$  milion euro investim që bëjnë  $50$  milion euro investim në zonë ekonomike, se sa ti kemi  $50$  biznese me nga  $100,000.00$  € investime që bëjnë  $5,000.000$  €. Zona ekonomike në Lumadhdh do të jetë si një pilot projekt pasi që do të merret si shembull edhe në zonën ekonomike në Banjësk. Lidhur me këtë projekt ai përkrahu propozimin e z.Lahu Drejtori i Drejtorisë për Pronë që prona të jepet në shfrytëzim sipas opsonit me tri (3) zona.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha** se nëse nisemi nga parimi që kompanive tu japim pronë me nga  $1$  hektar, ka drojën që shumë biznese do të mbesin jashtë kësaj zone ekonomike dhe ato ta fajësojnë komunën për mos ofrim të pronës në këtë zonë. Ai vlerësoi dhe shprehu dyshimin që ndonjë operator ekonomik do të arrij të punësoj  $200$  punëtor përfaktin se është e vështirë që në këto rrëthana të afrohet suksesshëm dhe të kemi numër të madh të punësuarve. Ai apeloi që kjo çështje të analizohet mirë ashtu që mos të lëshohen gabime sa i përket ndarjes së këtyre parcelave me qëllim që më vonë të fajësohet komuna.

**Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit-tha** se është privilegj që komuna po e realizon projektin e zonës ekonomike, dhe kjo për bëhet duke ju falenderuar qytetarëve dhe partisë NISMA Socialdemokrate, me në krye atë si kryetar, por edhe angazhimit të vëllait të tij që ka qenë këshilltar i ministrit. Andaj dëshiron të nënëvizon që këtë hapësirë prej  $14$  hektarëve duhet ndarë në mënyrë proporcionale duke u konsultuar me ekspertë të fushës përkatëse dhe se kjo zonë duhet ti punësoj së paku  $1000$  punëtor.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha** se krejt këto që po diskutohen janë jashtë rendit të ditës sepse tani jemi duke diskutuar vetëm për propozim-vendimin paraprak për dhënien e këtyre

pronave në shfrytëzim. Pastaj shtoi se nuk e habit fakti që po gjejnë pajtueshmëri partitë politike LDK dhe PDK për shkak të orientimit të tyre politik, por kemi këtu edhe disa të tjerë që kanë orientim tjeter politik që nuk pajtohen me këto dy parti në shembullin tonë kemi NISMEN Socialdemokrate. Konsideron se pika 1 e propozim-vendimit është gabim të cilin e ka potencuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa në këtë pikë thuhet: me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë me kompensim e pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh përkatesisht parcelat e evidentuara në certifikatën e pronësisë P-70202011-00435-1 e cila ka sipërfaqe prej 6 hektar dhe P-70202011-00435-3 me sipërfaqe prej 13 hektar, sipërfaqja e përgjithshme është 19 hektarë. Në rastin konkret ai propozon që të bëhet *ndarja në skicë e sipërfaqes apo që të thuhet pjesë nga parcelat e sipërcekura*, përfaktin se në terzin e këtyre parcelave në gjendjen faktike janë disa objekte ngjitur në kompozicionin e këtyre parcelave e që nënkuption që nuk janë 19 hektar tokë për dhënie në shfrytëzim. Lidhur me konkursin publik ai propozoi që të ndahet në zona dhe ato parcela me sipërfaqe më të vogël të ndahan më afër rrugës magjistrale. Zonat kishte me qenë mirë të jenë zona e parë I me sipërfaqe prej 30-50 ari, zona e dytë II nga 50-1 hektar dhe zona e tretë III mbi 1 hektarë.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së**-lidhur me pikën 1 të këtij propozim-vendimi paraprak, arsyetoj se këtë akt nuk e ka hartuar Drejtoria e Kadastrit por Zyra e Kryetarit. Sa i përket sipërfaqes bashkëngjitur me këtë propozim-vendim janë edhe certifikata e pronësisë dhe kopjet e planit ku është e qartësuar sipërfaqja e terrenit. Në këto sipërfaqe janë të ndërtuara disa shtëpi, që kapin një sipërfaqe prej 5 hektarësh në këtë zonë. Në kopjen e planit të bashkëngjitur me material e kemi identifikuar hapësirën, andaj propozoi që të plotësohet ky propozim-vendim me sa vijon: *me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë me kompensim e pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh pjesë nga parcela kadastrale P-70202011-00435-1, në sipërfaqe prej 8.77.90 ha nga sipërfaqja e përgjithshme prej 13.01.76 ha, si dhe parcela kadastrale P-70202011-00435-3 me sipërfaqe prej 6.08.10 ha, në sipërfaqe totale nga dy parcelat prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë*.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-kërkoi** të jepen sqarime sepse në rastin konkret po bëhet fjalë për një propozim-vendim për dhënin në shfrytëzim të dy parcelave dhe atë P-70202011-00435-1 dhe P-70202011-00435-3 dhe pyeti se zonimi apo ndarja e parcelave a do të bëhet para shpalljes së konkursit, sepse nëse ne marrim vendim për ndarjen e këtyre parcelave në sipërfaqe të ndryshme ato do të marrin një numër tjetër dhe vendim-paraprak nuk do të përputhet me numrat e parcelave që ne do ti ndajmë. Andaj ai vlerësoi se së pari duhet të ketë një dakordanc për ndarje të parcelave të cilat do të futeshin në elaborat kadastral dhe tani të sillet propozim-vendimi paraprak për aprovim në kuvend, në të kundërtën do të kemi problem sa i përket zbatimit të vendimit.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së**-duke ju referuar parafolësit sqaroi se ajo ngatërrimi i numrave të parcelave do të ndodhë saktësisht nëse do të fillohej me parcializimin e parcelave apriori para se ato jepeshin në shfrytëzim. Mirëpo zonimi nuk nënkuption detyrimisht parcializimin e parcelave, me zonim vetëm sa po jepen konturat e përgjithshme dhe mundësit për aplikim në tri zona për subjektet asariste dhe kjo e bënë shumë më të lehtë aplikimin nga ana e bizneseve.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha** se duhet të caktohen kriteret e zonimit duke aplikuar përqindje p.sh prej 1000-5000 m<sup>2</sup> me qenë 70% e sipërfaqes, ndërsa mbi 5000 m<sup>2</sup> të mbetet i hapur opzioni 30 % dhe kjo të futet si pikë e veçantë ky propozim dhe kjo do ta determinonte punën e komisionit dhe kështu zonimi do të realizohej më lehtë.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha** se kufizimi në sipërfaqe është me rrezik në largimin potencial bizneset që kanë potencial për investim dhe punësim sepse edhe nëse një operator aplikon për 3 parcela me nga 50 ari, prapë nuk krijon kushte për hapjen e një fabrike për prodhim. Kur të

hyjmë në konkurrencë dhe të vijnë ofertat komisioni do ti vlerësoj një nga një. Në këtë kontekst nuk do të mund ti kënaqim të gjithë por qëllimi është që ti hapim 500-1000 vende të reja të punës. Dhe me këtë përvojë do të vazhdojmë në zonën ekonomike në Banjësk ku atje ka hapësirë të mjaftueshme pasi që kemi rrëth 200 hektarë tokë për ti dhënë në shfrytëzim për bizneset.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-pyeti** se nëse një kompani hipotetikisht zotohet se do ti punësoj 100 punëtor dhe në fakt nuk e realizon një zotim të tillë atëherë a do ti vendos komuna ndonjë kusht apo urdhër për lirim të pronës.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-sqaroi** se me rastin e nënshkrimit të kontratës, komuna do të kërkoj një garancion bankarë në vlerë 5% dhe nëse operatori ekonomik nuk realizon investimin brenda afateve komuna ka të drejtë të tërheq garanconin dhe lëshon urdhër për lirim të pronës. Po ashtu kusht do të ketë edhe sa i përket të punësuarve dhe afati të realizimi të investimeve.

Në fund të debatit lidhur këtë pikë të rendit të ditës kuvendit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

**1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë me kompensim e pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh pjesë nga parcela kadastrale P-70202011-00435-1, në sipërfaqe prej 8.77.90 ha nga sipërfaqja e përgjithshme prej 13.01.76 ha, si dhe parcela kadastrale P-70202011-00435-3 me sipërfaqe prej 6,08.10 ha, në sipërfaqe totale nga dy parcelat prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.**

**2. Ngastrat kadastrale si në pikën 1 (një) të këtij vendimi, iu jepen në shfrytëzim afatgjatë subjekteve afariste për ushtrim të veprimitarive ekonomike sipas Ligjit për Zonat Ekonomike si vijon:**

**2.1. Në tri (3) vitet e para nga data e nënshkrimit të kontratës me komunën, nuk do të paguajnë kompensim, ndërsa pas tri (3) viteve do të paguajnë 0.05 € (pesë cent) për  $m^2$  në muaj.**

**2.2. Prona komunale iu jepet në shfrytëzim në afat prej nëntëdhjetë e nëntë (99) viteve.**

**3. Kuvendi i Komunës duhet të shpall konkurs publik për vendosje të subjekteve afariste në parkun industrial, bazuar në nenin 11 paragrafi 1 të Ligjit për Zonat Ekonomike Nr. 04/L-159 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 03/2014 për Procedurën Formën dhe Përbajtjen e Konkursit Kushtet dhe Kriteret për Vendosjen e Subjekteve Afariste Brenda Hapësirave të Zonave Ekonomike.**

**4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: certifikatat për të drejtën e pronësisë dhe kopja e planit për pronat që do të jepen në shfrytëzim afatgjatë.**

**5. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**5. Shqyrtimi i Propozim vendimit për formim të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;**

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-propozoi Ilmi Azemin për anëtar të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.**

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit-propozoi Agim Bregajn për anëtar të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.**

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-propozoi Gresa Mulin për anëtarë të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.**

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se nga ekzekutivi komunal janë për anëtarë të komisionit janë propozuar sipas detyrës zyrtare Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së, Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së, dhe Miran Halili nga Drejtoria për Bujqësi, por pasi ai është i ngarkuar me punë e zëvendësojmë me Refik Malokun drejtor i DSHP-së. Nga shoqëria civile kemi bërë thirrje publik konform legjislacioni por që nuk ka pasur përgjigje, andaj propozoi Isak Hysenin aktivist i shoqërisë civile. Po ashtu njoftoi kuvendit se si kryetar i komunës ka ftuar BIRNIN që ta monitoroj këtë proces ashtu që ky proces të jetë sa më transparentë.**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-sqaroi se numri i anëtarëve të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, është i caktuar me ligj dhe duhet të jenë pesë (5) anëtarë dhe nuk kemi të drejtë ta rrisim këtë numër.**

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se duhet ti referohemi preambulës së vendimit, dhe aty është baza ligjore, sepse në zbatim të procedurave të dhënies së pronës në shfrytëzim për zonën ekonomike, zbatojmë dy ligje njëkohësisht dhe atë: Ligjin për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim dhe Ligji për Zonat Ekonomike si ligj specifik. Andaj me qëllim të transparencës sa më të madhe të procesit për komision po zbatojmë ligjin për Zonat Ekonomike që nuk e kufizon numrin e anëtarëve për vlerësim të ofertave dhe propozoi që të plotësohet titulli i vendimit: *Vendim për Formim të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave dhe për Zbatim të Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.***

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit me 27 vota “për” 2 vota “kundër” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim formohet Komisioni për vlerësimin e ofertave dhe për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në parkun Industrial në Lumadh, të cekur në vendimin paraprak, përkatësisht, parcelat e evidentuara në certifikatën e pronësisë P-70202011-00435-1 dhe P-70202011-00435-3, pronë e Komunës së Vushtrrisë, në përbërjen si në vijim:**

- 1.1 Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit;**
- 1.2 Agim Bregaj, anëtar i kuvendit;**
- 1.3 Gresa Muli, anëtarë e kuvendit;**
- 1.4 Adnan Lahu, anëtarë i ekzekutivit të komunës;**
- 1.5 Berat Sadiku, anëtarë i ekzekutivit të komunës;**
- 1.6 Refik Maloku, anëtarë i ekzekutivit të komunës dhe**
- 1.7 Isak Hyseni, nga shoqëria civile.**

**2. Anëtarët e Komisionit Vlerësues në takimin e parë, me shumicë votash, zgjedhin kryesuesin i cili e kryeson komisionin.**

**3. Komisionit Vlerësues ka mandat për shqyrtim të ofertave vetëm për pronën e cekur në pikën një (1) të këtij vendimi.**

**4. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vlerësues duhet të zbatohen konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës me të cilin është e rregulluar kjo çështje.**

**5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e Komisionit Vlerësues.**

**6. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**6. Shqyrtimi i konkursit publik për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial;**

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-kërkoi që në vendimin për shpalljen e konkursit publik për dhënien e pronës në shfrytëzim në zonën ekonomik në Lumadh të futet edhe grancioni bankar i investitorit në vlerë prej 5% të vlerës së parashikuar të investimit me rastin e nënshkrimit të kontratës.**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-kërkoi që propozimet e dhëna në pikën me lart të inkorporohen në propozim –vendimin për shpalljen e konkursit publik.**

**Adnan Lahu, drejtëor i DGJKP-së-propozoi që tek paragrafi 2 i propozim-konkursit publik ku thuhet: **Madhësia e parcelave:** varësisht nga kërkjesat e subjekteve afariste, të shtohet teksti si në vijim: zona e parë (I) deri në 50 ari, zona e dytë (II) prej 50 ari deri në 1 hektarë dhe zona e tretë (III) mbi 1 hektarë.**

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha se nuk duhet ti ekzagjerojmë gjërat tej mase, pasi që nuk beson se ka kompani e cila do të mund ti punësoj 300 punëtor në Zonën Ekonomike në Lumadh. Ne kemi pasur premtimë se edhe kompania përpunimin e peshqve se do ti punëson 500 punëtor por që një gjë e tillë është larg realitetit.**

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-propozoi që sipërfaqja maksimale e cila duhet të jepet në shfrytëzim për një operator ekonomik duhet të jetë 5000 m<sup>2</sup> apo 50 ari. Këtë e arsyetoj me faktin se nuk ka kushte për të punësuar numër të madh të punëtorëve në atë zonë ekonomike. Ai duke elaburuar rastin e biznesit të tij privat, ceku se fabrika e tij për prodhimin e dyerve dhe dritareve ka një sipërfaqe prej 800 m<sup>2</sup> dhe mund të punësoj 20-30 punëtor, andaj vlerëson se me një sipërfaqe prej 20 ari është hapësirë i mirë për të zhvilluar biznes në atë zonë ekonomike, në këtë kontekst përsërit se sipërfaqja maksimale prej 50 ari do të ishte e mjaftueshme për zhvillim të kapaciteti biznesor në atë park industrial.**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-përsëriti se sipërfaqja prej 50 ari është e mjaftueshme për natyrën e mundësive që ofron ky park industrial. Në këtë aspekt ai vlerëson se nuk kemi nevojë që ne ti kufizojmë bizneset pasi që ato mund të ndërtojnë në sipërfaqe prej 5000 m<sup>2</sup> dhe në të mund të ndërtohen deri në 10000 m<sup>2</sup> objekt për arsyse se ndërtimi mund të bëhet në P+1, dhe destinimi mund të jetë për depo, por munde të ndërtohet edhe në 3 kate që të shfrytëzohet edhe për zyrën e biznesit, d.m.th shfrytëzimi mund të jetë maksimal i pronës, që iu jepet mundësia shumë bizneseve të qytetit që kanë nevojë për këtë lokalitet. Ai potencoi se ideja e tyre është që ky park i biznesit të jetë**

tregim i suksesit e jo dështimit, dhe kjo do të mund të bëhej duke caktuar maksimumin deri në 50 arri të sipërfaqes në zonën ekonomike. Andaj kerkoi që ky propozim të del në votim, ku do të obligonte komisionin dhe qeverinë komunale të veprohet sipas tij.

**Shpëtim Zhegrovë, anëtar i kuvendit**- tha se nuk është mirë të flitet me emra, të bizneseve, dhe shtoi se parimi shështë vlerësuar se ai park i biznesit me sipërfaqen që ka nuk krijon kushte për zhvillimin e bizneseve të mëdha duke ju dhënë pronë me nga 1 apo 2 hektarë, dhe ceku se nëse shkohet me sipërfaqe minimum 10 arri deri në 50 arri, cilësia do të jetë më e madhe, kërkesa do të jetë më e madhe dhe shumica e bizneseve të cilat do të vendosen aty do të jenë të Komunës së Vushtrrisë, kurse nëse shkohet me sipërfaqe të madhe, pjesa dërmuese e atyre bizneseve nuk do të jenë të Vushtrrisë. Andaj ai pandeh se komision duhet të ketë shumë kujdes pasi ai do ta ketë barrën e përgjegjësisë, sepse nëse kemi për bazë punësimin të punësuarit e ri dhe të punësuarit ekzistues problemi më i madh do të jetë tek kjo, sepse ka kompani të mëdha që i ka 200 punëtor, vjen aplikon dhe merr 1 hektarë pronë dhe i punëson 5 persona dhe objektin e lenë si depo, kësisoj mundon se ky park i biznesit nuk ka kapacitete për dhënie të pronës mbi 50 arri dhe ai voton për propozimin deri në 50 arri të cilin e apostrofoj më lartë sepse mendon se kjo i ndihmon bizneset e komunës së Vushtrrisë.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-kérkoi nga ekzekutivi komunal që mos të ngutet me shpalljen e konkursit duke bërë ftesë publike, kjo për faktin se punimet në atë zonë industriale nuk kanë përfunduar. Andaj kérkoi që ky konkurs mos të shpallet pa u bërë pranimi teknik i projektit parku industrial në Lumadh

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-tha se pajtohet me mendimin që mos të ngutemi me këtë konkurs, pasi shumë gjëra janë të paqarta, pasi që nëse një kompanie i japim 1 hektar pronë, dhe kompanisë tjetër nuk mund ti japi as edhe 20 arri pronë atëherë do të kemi ankesa nga kompanitë dhe qytetarët tanë.

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-sqaroi** se punimet në zonën ekonomike janë afër finalizimit ku është duke u vendosur ndriçimi publik dhe asfaltimi i rrugëve. Sa i përket zhvillimit të infrastrukturës në këtë zonë ekonomike, kemi qenë të varura nga 3 elementet kjo për faktin se në ato parcela kalon gypi F-3000 i kanalit Ibër Lepencit, në pjesën prapa kalon një gyp i ujësjellësit, ndërsa po në këto parcela kemi edhe tension të lartë të energjisë elektrike andaj në zhvillim infrastrukturor kemi qenë të kushtëzuar nga këto elemente. Nuk do të ketë mundësi të jepen në shfrytëzim 10 arri sipërfaqe, për shkak të zgjidhjes së infrastrukturës sepse kemi qenë të detyruar në atë formë, nuk mund ta ndajmë një parcelë prej 10 arri për një operator ekonomik i cili ka një distancë 10 metra ndërsa gjatësia e saj është 100-150 metra sepse kështu nuk do të ketë kurrfarë funksioni ajo parcelë, çka mundemi të bëjmë është që minimumi i mundshëm duhet të jetë 30 deri në 50 arri sipërfaqe ashtu që ajo parcelë të jetë funksionale. Në detaj është menduar të bëhet zonimi ashtu që bizneset të ndihen të lira që ta gjejnë vetën aty ku ato i plotësojnë kriteret dhe propozoi zona e parë I 30 deri në 50 arri, zona e dytë II 50 arri deri 1 hektarë dhe zona e tretë III mbi një 1 hektarë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi i kuvendit i hodhi në votim dy propozime fillimisht propozimin e anëtarit të kuvendit z. Shpëtim Zhegrovë për dhënie të pronës në shfrytëzim në zonën ekonomike në sipërfaqe deri në 50 arri, propozim i cili mori 13 vota, "për" ndërsa propozimi tjetër për aplikimin e parimit të zonimit të parkut industrial në Lumadh në tri (3) zona dhe atë: zona e parë (I) deri në 50 arri, zona e dytë (II) prej 50 arri deri në 1 hektarë dhe zona e tretë (III) mbi 1 hektarë, ky propozim mori 19 vota "për" që

**konstatohet si i aprovar dhe inkorporohet në vendimin për shpalljen e konkursit publik për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh.**

**Vendndodhja:** Fshati Lumadh Komuna e Vushtrrisë, kilometri i 18-të, në rrugën nationale Prishtinë – Mitrovicë.

**Parcelat:** P-70202011-00435-1, në sipërfaqe prej 8.77.90 ha, dhe parcela kadastrale P-70202011-00435-3 me sipërfaqe prej 6,08.10 ha.

**Madhësia e parcelave:** varësisht nga kërkesat e subjekteve afariste, zona e parë (I) deri në 50 ari, zona e dytë (II) prej 50 ari deri në 1 hektarë dhe zona e tretë (III) mbi 1 hektarë.

**Veprimtaritë e lejuara në parkun industrial:** Në parkun industrial mund të zhvillohet çdo veprimtari afariste e cila nuk cenon rendin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisin, florën dhe faunën dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

**Përparësitë për vendosje në parkun industrial:** Me rastin e shqyrtimit të aplikacioneve përparësi do të kenë ato biznese të cilat merren me veprimtari prodhuese, përpunimit të produkteve si dhe ato të cilat rrisin numrin e punëtorëve në raport me numrin ekzistues të biznesit.

**E drejta e aplikimit:** Të drejtë aplikimi kanë të gjitha bizneset vendore dhe të huaja të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret që janë të përcaktuara në konkurs, që kanë për qëllim zhvillimin dhe zgjerimin e kapaciteteve biznesore dhe rritjen e zhvillimit ekonomik.

**Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:** Me rastin e aplikimit për të u vendosur në park industrial të interesuarit duhet dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i plotësuar me të dhënat e kërkua
- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Historiati i kompanisë (biznesit)
- Veprimtaria që do ta zhvilloj
- Projekti ideor

Bizneset e aprovuara në parim brenda afatit kohorë prej 30 (tridhjetë) ditësh duhet të sjellin dokumentacionin në vijim:

- Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës për përbushjen e obligimeve tatimore
- Dëshminë nga ATK për numrin aktual të të punësuarve
- Planin e Biznesit
- Garacionin bankar prej 5% të vlerës së parashikuar të investimit me rastin e nënshkrimit të kontratës

**Kriteret për vlerësim:**

Punësimi 40 pikë;

Vlera investive 30 pikë;

Lloji i veprimtarisë 30 pikë;

- *Prodhuese 30 pikë,*
- *Përpunuese 20 pikë,*
- *Shërbyese 10 pikë,*

**Afati i dhënies në shfrytëzim** – nëntëdhjetë e nëntë (99) vite nga dita e nënshkrimit të kontratës.

**Tërheqja e formularit:**

Formulari për aplikimit mund të merret në zyrën pritëse të komunës – kati përdhes çdo ditë pune nga ora 8;30 deri në ora 15;30, ose në faqen zyrtare të komunës.

**Dorëzimi i dokumentacionit:**

Formulari i plotësuar se bashku me dokumentacionin tjeter të kërkuar me konkurs duhet dorëzuar në mënyrë fizike në zyrën pritëse të komunës (në pliko të mbyllura të vulosura me vulën e biznesit), i cili i adresohet Komisionit për Vlerësimin e Ofertave dhe për Zbatim të Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

**Afati i për aplikim:** Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Vërejtje:** aplikacionet e dorëzuara pas ditës së mbylljes së konkursit nuk do të merren në shqyrtim përveç atyre që arrijnë përmes postës të cilat mbajnë datën e fundit të caktuar në konkurs deri në ora 16:00.

**E drejta në ankesë:** Bizneseve të cilave iu refuzohet e drejta për të u vendosur

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, parcela kadastrale P-70202044-00586-0 me sipërfaqe prej 25832m<sup>2</sup>, P-70202044-00529-0 me sipërfaqe prej 15761m<sup>2</sup>, P-70202044-01096-0 me sipërfaqe prej 2100m<sup>2</sup>, ZK Navalani, parcela P-70202053-00366-1 në sipërfaqen prej 25436m<sup>2</sup>, ZK Prelluzhë, parcela P-70202063-00037-0 ne sipërfaqe prej 54774m<sup>2</sup>, ZK Strovc, parcela P-70202037-00051-0 me sipërfaqe prej 100543m<sup>2</sup>, parcela P-70202037-00337-0 me sipërfaqe prej 55449m<sup>2</sup>, parcela P-70202037-00699-0 me sipërfaqe prej 23272m<sup>2</sup>, ZK Kollë, parcela P-70202040-00431-0 me sipërfaqe prej 101525m<sup>2</sup>, ZK Dumnicë e Llugës, parcela P-70202028-00412-1 me sipërfaqe prej 35232m<sup>2</sup>, parcela P-70202028-00412-4 me sipërfaqe prej 6211m<sup>2</sup>, ZK Stanovc i Poshtëm, parcela P-70202061-0079K-2 me sipërfaqe prej 14126m<sup>2</sup>, ZK Gjelbishtë.

1.1 Parcela kadastrale P-70202044-00586-0 me sipërfaqe prej 25832m<sup>2</sup>, P-70202044-00529-0 me sipërfaqe prej 15761m<sup>2</sup>, P-70202044-01096-0 me sipërfaqe prej 2100m<sup>2</sup>, ZK Navalani, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes

konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.2** **Parcela P-70202053-00366-1** në sipërfaqe prej 25436m<sup>2</sup>, ZK Prelluzhë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.3** **Parcela P-70202063-00037-0** në sipërfaqe prej 54774m<sup>2</sup>, ZK Strovc, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.4** **Parcela P-70202037-00051-0** me sipërfaqe prej 100543m<sup>2</sup>, parcela P-70202037-00337-0 me sipërfaqe prej 55449m<sup>2</sup>, parcela P-70202037-00699-0 me sipërfaqe prej 23272m<sup>2</sup>, ZK Kollë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.5** **Parcela P-70202040-00431-0** me sipërfaqe prej 101525m<sup>2</sup>, ZK Dumnicë e Llugës, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.6** **Parcela P-70202028-00412-1** me sipërfaqe prej 35232m<sup>2</sup>, ZK Stanovc i Poshtëm, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**1.7** **Parcela P-70202028-00412-4** me sipërfaqe prej 6211m<sup>2</sup>, ZK Stanovc i Poshtëm, jepen në shfrytëzim afatshkurta për 10 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.

**1.8** **Parcela P-70202061-0079K-2** me sipërfaqe prej 14126m<sup>2</sup>, ZK Gjelbishtë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

**2. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të zhvilloj procedurat për shpalljen e ankandit si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.**

**3. Pjesë e këtij vendimi paraprak janë: certifikata e pronës dhe kopja e planit.**

**4. Ky Vendimi paraprak hynë në fuqi pesëmbëdhjete (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit 01 nr. 89/20, dt. 28.05.2020;**

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-paraqiti** sqarime hyrëse lidhur me korrigjimin e këtij propozim-vendimi pasi janë konstatuar se janë përvjedhur lëshime teknike e përbajtjesore në referim të numrit të vendimit i cili duhet të ndryshohet dhe plotësohet. Referenca duhet të jetë në ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01nr. 89/20 datë 28.05.2020 për formimin e Komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, parcela kadastrale P-70202027-00007-0, në sipërfaqe prej 53413 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale.

**Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit-propozoi Ismet Hajrizin** për anëtar të komisionit nga radhët e LDK-së.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01nr. 89/20 datë 28.05.2020 për formimin e Komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, parcela kadastrale P-70202027-00007-0, në sipërfaqe prej 53413 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Studime e Poshtme si në vijim:**

**1.1 Në pikën 2, nënpika 2.1, në vend të z. Agron Përçuku, emërohet z. Ismet Hajrizi, anëtar i kuvendit, nga radhët e LDK-së.**

**2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtari i sipërcekur i komisionit dhe Sekretaria e Kuvendit.**

**3. Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit 01 nr. 57/18, dt. 22.02.2018;**

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01nr. 57/18 datë 22.02.2018 për themelim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si në vijim:**

**1.1 Në paragrafin 1, pika 1.12, në vend të Nebojsha Zdravkoviç, emërohet z. Spasoje Stefanoviq;**

**1.2 Në pikën 1.15, në vend të Adnan Hodiq, emërohet Selatin Emini.**

**1.3 Në paragrafin, pika 1.5 në vende të Bajram Kela emërohet Toger Besfort Kruma.**

**2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Zyra e Kryetarit dhe Sekretaria e Kuvendit.**

**3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

**10. Shqyrtimi i Propozim – vendimeve për emërim të komisionit për përgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë;**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se ka qenë propozim i tij në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa që këto propozime të fuzionohen të gjitha në një propozim-vendim, por që me qëllim të respektimit të procedurave le të shkohet me votimin të veçantë dhe për secilën shkollë me propozim-vendim të caktuar.**

**Afram Namani, drejtor i DA-së-sqaroi se procedurat për zgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendës drejtoreve kanë ndërruar, dhe për secilën shkollë dhe profil ministria dërgon zyrtar përkatës nga fusha profesionale përkatës për anëtar të këtyre komisioneve.**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se ky propozim-vendim është hartuar konform Udhëzimit administrativ dhe këta emër janë adekuat për këtë komision.**

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim formohet Komisionit për përgjedhje për vendet e punës: Zëvendës drejtor në SHMT ”Lutfi Musiqi” në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:**

- 1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe personel i DKA-së;**
- 1.2. Hadije Zuçaku, nga këshilli i prindërve;**
- 1.3 \_\_\_\_\_, përfaqësues i MASHT-it.**

**2. Komisioni do ti zhvilloj të gjitha procedurat për përgjedhjen e Drejtoreve dhe Zëvendësdrejtoreve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.15/2019 Për Detyrat, Përgjegjësit, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe aftësues Parauniversitar.**

**3. Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat deri në përfundimin e konkursit nr.45774/20 të datës 08.10.2020, të Drejtorisë Komunale të Arsimit.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisioni i lartë cekur.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi tetë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**1. Me këtë vendim formohet Komisionit për përgjedhje për vendet e punës: Drejtor në SHFMU ”Hajrullah Shala” Akrashticë, SHFMU ”Bahri Kuqi” Shtruherë, SHFMU ”Nazmi Zhegrova” Stanoc i Poshtëm, SHFMU ”Lumni Surdulli” Samadrexhë, SHFMU ”Rilindja”**

**Maxhunaj, SHFMU” Emin Duraku” Novolan dhe Drejtor në SHFMU ”Bajram Curri” Dumnicë e Llugës, në këtë përbërje:**

**1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe personel i DKA-së;**

**1.2. Hadije Zuçaku, nga këshilli i prindërve;**

**1.3 \_\_\_\_\_, përfaqësues i MASHT-it.**

**2. Komisioni do ti zhvilloj të gjitha procedurat për përgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.15/2019 Për Detyrat, Përgjegjësit, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe aftësues Parauniversitar.**

**3. Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat deri në përfundimin e konkursit nr.45771/20 të datës 08.10.2020, të Drejtorisë Komunale të Arsimit.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisioni i lartë cekur.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi tetë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**1. Me këtë vendim formohet Komisionit për përgjedhje për vendet e punës: Drejtor në Gjimnazin ”Eqrem Çabej” dhe Drejtor në SHMP ”Bahri Haxha” në Komunën e Vushtrrisë, me këtë përbërje:**

**1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe personel i DKA-së**

**1.2. Hadije Zuçaku, nga këshilli i prindërve**

**1.3 \_\_\_\_\_, përfaqësues i MASHT-it.**

**2. Komisioni do ti zhvilloj të gjitha procedurat për përgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.15/2019 Për Detyrat, Përgjegjësit, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe aftësues Parauniversitar.**

**3. Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat deri në përfundimin e konkursit nr.45765/20 të datës 08.10.2020, të Drejtorisë Komunale të Arsimit.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisioni i lartë cekur.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi tetë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**1. Me këtë vendim formohet Komisionit pér përgjedhje pér vendet e punës: Drejtor në "SHMU-2"në Vushtrri, me këtë përbërje:**

- 1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe personelit i DKA-së;**
- 1.2. Hadije Zuçaku, nga këshilli i prindërve;**
- 1.3. \_\_\_\_\_, përfaqësues i MASHT-it.**

**2. Komisioni do ti zhvilloj të gjitha procedurat pér përgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.15/2019 Pér Detyrat, Përgjegjësit, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe aftësues Parauniversitar.**

**3. Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat deri në përfundimin e konkursit nr.45768/20 të datës 08.10.2020, të Drejtorisë Komunale të Arsimit.**

**4. Pér zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisioni i lartë cekur.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi tetë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**1. Me këtë vendim formohet Komisionit pér përgjedhje pér vendet e punës: Drejtor në SHF" Mustafë Venhari" dhe Drejtor në SHF" Naim Frashëri" në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:**

- 1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe personel i DKA-së;**
- 1.2. Hadije Zuçaku, nga këshilli i prindërve;**
- 1.3. \_\_\_\_\_, përfaqësues i MASHT-it**

**2. Komisioni do ti zhvilloj të gjitha procedurat pér përgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.15/2019 Pér Detyrat, Përgjegjësit, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe aftësues Parauniversitar.**

**3. Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat deri në përfundimin e konkursit nr.45767/20 të datës 08.10.2020, të Drejtorisë Komunale të Arsimit.**

**4. Pér zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Arsimit dhe Komisioni i lartë cekur.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi tetë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**11. Shqyrtimi i Propozim – vendimit pér caktimin e lokacionit pér ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq – dega në Vushtrri;**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-njofton** se grupei kuvendar i PDK-së e përkrah propozim-vendimin në fjalë, dhe konsideron se po bëhet një zgjidhje e mirë për të krijuar kushte që Kryqi i Kuq të ketë një objekt të vetin ku do ti kryej aktivitetet e tij. Edhe pse kjo pronë nuk është e komunës, kryetari ka dekluaruar se ka marr pëlqimin nga Qeveria e Kosovës për zhvillimin e këtij projekti.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-pyeti** se ku është caktuar ky lokacion në cilën pjesë të qytetit.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-sqaroi** se lokacion për ndërtimin e këtij objekti është caktuar tek stacioni i vjetër i autobusëve afér QMF-së së re, përkatësisht në afërsi të tregut të qytetit.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-tha** se i bashkëngjitet mendimit se është shumë e nevojshme ndërtimi i këtij objekti ashtu që Kryqi i Kuq të realizoj funksionin e vetë. Mendon se ana procedurale dhe ligjore e këtij propozim është në rregull, por nëse konstatohen të meta tjera të kësaj materie atëherë kuvendi është i gatshëm që të harmonizoj çdo aspekt tjetër ligjor.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq-Dega në Vushtrri, në pjesë të parcelës kadastrale P-K4103-1, në sipërfaqe prej 250 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5696 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Kooperativa Bujqësore në Vushtrrisë.**

**2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.**

**3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit.**

**4. Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A Vushtrri;**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha** se janë të kënaqur që po realizohet krijimi i Ndërmarrja Publike Lokale “Përparimi” SH.A Vushtrri, për të cilën kemi debatuar para një viti, për këtë ndërmarrje ka nevojë Qyteti i Vushtrrisë dhe funksionalizimi i saj do ta lehtësoj ofrimin e shërbimeve në shumë sfera të komunës ndaj qytetarëve. Andaj krahas kësaj e përkrahim caktimin e lokacionit të kësaj ndërmarrje me shpresë që nuk do ta dalin probleme pasi në këtë lokacion ndodhet edhe arkivi i qytetit.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-njoftoi** kuvendin se më herët është marrë vendimi për rrënimin e objektit tek ish-TMK-ja dhe nëse është marrë ai vendim i njëjtë duhet të shfuqizohet.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-** propozoi që në këtë vendim të futet një paragraf ku shfuqizohen të gjitha vendimet e kuvend lidhur me objektin e ish-TMK-së. Tutej ai i falënderoi të gjitha grupet politike në kuvend për mbështetjen e këtij propozim-vendimi, duke shtuar se kthimi i ndërmarrjes publike komunale “Përparimi” në Vushtrri është vërtet një e arritur e madhe, ku kjo ndërmarrje do të kryen një sërë aktivitetesh në ofrimin e shërbimeve për qytetarët tanë, duke filluar

nga parkingjet publike, hapësirat e përbashkëta banesore, hapësirat e gjelbërta në qytet, tregu, sigurimi fizik i objekteve komunale dhe pastrimi i tyre. Është një padrejtësi e madhe që ju ka ndodhur jo vetëm punëtorëve të sigurimit dhe pastrimit në komunën tonë por gjithandjej në Kosovë, kur dhjetë vite më parë janë larguar si tepricë teknologjike dhe janë kaluar në sektorin privat, këta punëtor kanë pasur shumë probleme, shumë herë nuk iu është paguar trusti pensionalë, ka pasur probleme me paga e të ngjashme. Andaj një nga detyrat kryesore të “Përparimit” në Vushtrri do të jetë sigurimi fizik i objekteve komunale duke i përfshirë edhe shkollat, të gjithë punëtoret e sigurimit dhe pastrimit do të kalojnë si punëtor të ndërmarrjes “Përparimi”. Tash e tutje komuna, një sërë projektesh që janë në buxhetin e vitit 2021 nuk do të ketë nevojë ti tenderoj, por do të bëj kontratë siç e parasheh Ligji i Prokurimit brenda shtëpisë me “Përparimin” duke i dhënë këto shërbime Ndërmarrjes “Përparimi” dhe njëkohësisht duke krijuar punësim. Tutej njoftoi se të gjitha parkingjet e qytetit do të kalojnë në menaxhimin e kësaj ndërmarrje. Aktualisht kemi 400 parkingje prej të cilave nuk inkasojmë asnjë cent si komunë nëse vetëm 1 € në ditë marrim nga këto parkingje bëjnë 400 € në ditë për komunën për një 1 viti komuna do të mund të inkasojë afër 130,000.00 € nga ky aktivitet dhe për këtë do të krijohen disa vende pune dhe menaxhimi do të jetë më i mirë. Jemi dëshmitar të zhvillimit të hovshëm të qytetit tonë në fushën e ndërtimit dhe banesave kolektive, andaj do të ketë nevojë për mirëmbajtjen e ashensorëve që edhe këtë shërbim do ta ofroj kjo ndërmarrje. Një i qytet i vogël për nga madhësia por jo nga rëndësia sikur është qyteti i Vushtrrisë, nuk do të ketë mundësi të ketë për secilën fushë ndërmarrje të veçantë për këto aktivitet, por të gjitha do ti fuzionoj në një ndërmarrje të vetëm me qëllim të realizimit të parimit të ekonomizimit ku do të kemi vetëm një bord, një drejtor dhe ndoshta disa zëvendës drejtor. Kjo ndërmarrje është përtëj zotimeve të tij elektorale dhe është i lumtur që është krijuar kjo mundësi që si emërtimi Ndërmarrje “Përparimi” është një kujtesë e mirë historike nga e kaluar. Në mbledhjen e radhës do të caktojmë komisionin e aksionarëve, ky komision do të shpallë konkursin për anëtar bordi dhe pastaj ky bord do ta zgjedh drejtorin e Ndërmarrjes “Përparimi”. Në fund falënderoi të gjithë për punën që kanë bërë për ngritjen e kësaj ndërmarrje, dhe beson që do të zgjedhët njerëzit më të mirë që do të punojnë me dashur për këtë ndërmarrje.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

- 1. Me këtë vendim caktohet lokacioni i Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” Sh. A, në objektin e ish TMK-së në Vushtrri, që gjendet në pjesën e parcelës kadastrale P- 2358-12, në sipërfaqe prej 1550m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 41655m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komuna së Vushtrrisë.**
- 2. Me këtë vendim shfuqizohen të gjitha vendimet paraprake të aprovuara nga kuvendi i komunës që lidhen me objektin e ish TMK-së.**
- 3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Mjedisit.**
- 4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit**

**5. Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

- 13. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal;**
- 14. Shqyrtimi i Draft - Strategjisë Zhvillimore të Komunës për vitet 2020 – 2025 (shqyrtimi parë);**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-pyeti se kusht është përfaqësues i hartimit të këtij dokumenti, pasi ky draft ka mjaft lëshime, të cilat i ka potencuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa si p.sh defektet vërehen tek përkufizimet dhe shkurtesat të cilat disa janë në gjuhen angleze e disa në gjuhën shqipe të cilat duhet të korrigohen dhe njëjtësohen. Duke lexuar me një vëmendje më të posaçme del se ky dokument i referohet në shumë vende PZHU-së, duhet ti themi autorit se nuk kemi më Plan Zhvillimor Urban, kemi PZHK dhe do ti kemi edhe hartat zonale, do ti kemi planet e hollësishme. Ekziston dyshimi se kjo strategji është e kopjuar si dokument nga ndonjë komunë tjeter, këtë e përforcon fakti se në disa vende dokumenti i referohet emërtimit Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Bujqesi e që dyshimi qon se ky dokument është kopjuar nga Komuna e Pejës. Pastaj ceku një gabim tjeter të autorit, në referenca, siç është Statutit i Komunës dhe Ligji për Kufijtë Administrativ, sipas statutit kemi 67 emërtime të vendbanime në territorin e komunës, ndërsa me Ligjin për Kufijtë Administrativ i kemi 64 zona kadastrale, gjë që zona kadastrale mund ti ketë edhe dy vendbanime brenda një zone kadastrale në dokument nuk kemi harmonizim mes këtyre dy referencave që është thirrur autori. Autori i dokumentit nuk i ka marrë këto emërtime as sipas ligjit dhe as sipas statutit. Në rastin e referimit në vendbanime autori i ka harruar dy sosh Dumnicën e Epërme dhe Sfaraçakun e Poshtëm dhe i cekë 65 prej tyre d.m.th autori as nuk është bazuar në ligj e as në statut të komunës këtu duhet të bëhet harmonizimi. Autori sikur ka dashur ta qetë komunën në lajthitej sepse lidhur me emërtimin e vendbanime dhe lagjeve urbane i referohet statutit duke cekur faqen por numërimin e tyre e evidenton gabimisht.**

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

- 1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Strategjia për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2020-2025.**
- 2. Diskutimi publik fillon nga data 30 nëntor 2020 dhe zgjat deri më 30 dhjetor 2020.**
- 3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.**
- 4. Obligohet zyra e kryetarit të komunës që si sponsor i draft-strategjisë në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2020 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet zyra e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo**

propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-strategjisë në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin dhjetor 2020.

**5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.**

**15. Shqyrtimi i Draft – Strategjisë të përkrahjes së prodhuesve në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi parë);**

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-falënderoi** të gjithë anëtarët e kuvendit për përkrahjen e këtyre dy koncept dokumenteve, dhe ftoj të gjitha bizneset dhe palët e interesit dhe ekspertet që gjatë këtij muaj të jatin propozimet e tyre ashtu që të kemi një dokument sa më të kompletuar. Ai e vlerësoi lartë faktin që komuna për herë të parë do të bëhet me strategji për përkrahjen e prodhuesve vendor. Pastaj shtoi se komuna jonë gradualisht duhet të kaloj nga buxheti për asfalt, në buxhet të zhvillimit ekonomik, ndërsa si komunë jemi ndër të parët që kemi hartuar këtë dokument strategjik. Tute bëri të ditur se këto dy dokumentet janë bërë përmes donatorëve, dhe bashkëfinancimit dhe hartimi i tyre është një hap i drejt në drejtimin e duhur për ti vënë konturat e përgjithshme të zhvillimit të komunës sonë duke i përkrahur prodhuesit vendor në kuadër të Komunës së Vushtrrisë. Me këtë dokument është synohet zhvillimi në staza të qëndrueshme i komunës sonë edhe përmes krijimi të oazave tatimore, dhe lehtësirave tjera tatimore e fiskale që në instancë të fundit kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të komunës tonë.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

**1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Strategja për Përkrahje e Prodhuvesve në Komunën e Vushtrrisë.**

**2. Diskutimi publik fillon nga data 30 nëntor 2020 dhe zgjat deri më 30 dhjetor 2020.**

**3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.**

**4. Obligohet zyra e kryetarit të komunës që si sponsor i draft-strategjisë në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2020 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet zyra e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-strategjisë në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin dhjetor 2020.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.**

17. Shqyrtimi i Draft-rregullores për shfuqizimin e rregullores të tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2021;

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit me vota “unanime” vendosi që ta shfuqizoj Rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2021.*

18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e normave të tatimit në pronën e paluajtshme;

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha** se me këtë propozim kemi një përshkallëzim dhe ngritje të normave tatemore, dhe nuk e di bazën se këto norma a janë nga niveli qendror, apo janë propozuar nga qeveria komunale, kemi pasur raste kur norma tatemore për banim ka qenë 13 %, edhe pse për këtë mund të thuhet se kjo nuk është reale pasi një është bërë rivlerësimi i shkallës së amortizimit ashtu siç kërkohet me ligj. Ani vlerësoi se nëse çështja e përcaktimit të këtyre normave tatemore nuk është bërë nga niveli qendror por është në kompetencën e komunës atëherë të shikohet mundësia e uljes së tyre pasi sipas ligjit në fuqi.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-njoftoi** se në raportin e auditorit kemi pasur vërejtje sa i përket rregullores të tatimit në pronë, pasi kemi shpërputhje me normat që i përcakton Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave. Andaj këtë rregullore e ka kthyer mbrapsht ministria e linjës dhe e njëjtë duhet të shfuqizohet dhe normat e tatimit në pronë duhet të vendosen me vendim të kuvendit.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha** se është e vërtet që shkallën e vlerësimit e bënë ministria, por që në bazë të legjisacionit normat tatemore i cakton kuvendi me vendim, dhe në rastin konkret është mirë të shikohet mundësia e uljes së këtyre normave.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

**1. Me këtë vendim bëhet caktimi i normave tatemore për të gjitha kategoritë e pronave me përjashtim të kategorisë pronë publike dhe atë si në vijim:**

Lloji i pronës	Norma e tatimit në %
Pronë rezidenciale (banesë-apartmant)	0,15
Njësi rezidenciale-parcelë	0,15
Pronë rezidenciale - shtëpi	0,15
Pronë kómmerciale	0,21
Njësi komerciale-parcelë	0,18
Pronë industriale	0,18
Njësi industriale-parcelë	0,18

<b>Pronë bujqësore</b>	<b>0.15</b>
<b>Njësi bujqësore-parcelë</b>	<b>0,15</b>
<b>Njësi pyjore parcelë</b>	<b>0,15</b>
<b>Pronat e pa-meremetuara dhe jo të gatshme për banim</b>	<b>0.15</b>
<b>Garazhet</b>	<b>0.15</b>
<b>Pronat e braktisura</b>	<b>0.15</b>
<b>Pronat komerciale (pishinat, fushat sportive etj).</b>	<b>0.21</b>
<b>Pronat e pa-meremetuara dhe jo të gatshme komerciale</b>	<b>0.20</b>

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtorit tjera kompetente komunale.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

19. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-përsëriti kërkesën e tij për ofrimin e informatës me shkrim nga Drejtoria e Prokurimit lidhur me kontratën për hartimin e projekteve.**

**Mbledhja përfundoi në ora 15:18.**

Bastri Duraku  
  
 Procesmbajtës

Nasuf Aliu  
  
 Kryesues i Kuvendit


  
 REPUBLIKA KOSOVA  
 ASSEMBLY OF THE  
 REPUBLIC OF KOSOVO